

POTASI

Eshtë element shumë i rëndësishëm në funksionet fiziologjike e biokimike të pemës. Influencon ndjeshëm në proceset e transpimitit e kryesisht në rregullimin e mekanizmit të hapjes së gojëzave të gjetes. Ndikim të madh ky element ushtron edhe në cilësinë e frutave e konservimin e tyre.

KALCIUMI

Eshtë element shumë aktiv i rregullimit të gjendjes koloidale të protoplazmës qelizore. Ndikon në rezistencën mekanike të degëve e në mënyrë të veçantë zgjat kohën e pjekjes së frutave.

MAGNEZI

Eshtë elementi themelor në sintezën e klorofilës e për pasojë në procesin e fotosintezës.

HEKURI

Merr pjesë në përbërjen e enzimave të ndryshme të cilat rregullojnë proceset oksidreduktive siç janë frymemarrja e fotosinteza.

BORI

Konsiderohet element me influencë të rëndësishme në mbirjen e polenit si dhe në formimin e luleve, të frutave dhe të rrënjëve.

Në ambientin ekologjik organizmat bimore jetojnë në një ekuilibër të përhershëm natyror.

Kultivimi i vazhdueshëm i drufrutorëve modifikon ekuilibrat mes specieve bimore e organizmave të mjedisit dhe zvogëlon në mënyrë progresive pjellorinë e tokës.


Konsumi i vazhdueshëm i elementëve minerale të terrenit nga ana e bimëve për prodhimin e frutave ul në mënyrë të ndjeshme pjellorinë e tokës, fenomen i cili kërkon reintegrimin e herë pas herëshëm të substancave minerale nëpërmjet plehimit.



Koha e plehimit varet nga konsumet më të mëdha të elementëve mineral nga ana e specieve e kultivarëve të ndryshëm. Duhet të dihet sasia e elementëve që largohen nga toka për një plehrim sa më racional.

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

PLEHRIMI NË KULTURAT DRUFUTURE



ATHINA LLAMBRO

E-mail qttpemtarivlore@yahoo.com

PLEHRIMET ORGANIKE

Karakteristikat e plehrimeve organike

1. Përmirësojnë strukturën e tokës.
2. Janë lehtësisht të absorbueshme nga ana e pemëve frutore.
3. Përmirësojnë përmbajtjen e lagështirës tokësore.
4. Ruajnë Ph neutral të tokës.
5. Përmirësojnë pjellorinë kimike - fizike - biologjike të terrenit.

PLEHRIMET MINERALE

PRANVERË

FOSFORI: Duhet të shpërndahet pothuajse gjysma e sasisë vjetore të plehrave fosfatike. Fosfori ka efekt stimulues për fillimin e vegjetacionit dhe ndikon pozitivisht mbi rritjen e zhvillimin e aparatit rrënjor.

AZOTI

Fillim i vegjetacionit

Lulëzim

Lidhja e frutave

Deri në fillimin e lulëzimit pemët frutore përdorin për nevojat e tyre me azot rezervat që ato kanë grumbulluar vitin e mëparshëm. Mbas kësaj faze duhet të shpërndahet 40%-50% të nevojave vjetore të bimës për këtë element pasi ajo duhet të përballojë konsumin e madh që kërkon rritja e vegjetacioni të ri.

VERË: RITJA E FRUTAVE

AZOTI

Në pemtoret me pemë me ngarkesë të madhe me fruta duhet të realizohet një plehrim i dytë duke përdorur 20-30% të nevojave për këtë element.

POTASI

FUNDI I RITJES SË DEGËVE

Në pemtoret me pemë me ngarkesë të madhe me fruta duhet të realizohet një plehrim i dytë duke përdorur 20-30% të nevojave për këtë element.

VJESHTE (MBARIMI I VEGJETACIONIT)

AZOTI:

Në këtë fazë konsumi i azotit është më i lartë pasi bima përveç plotësimit të nevojave për rritjen dhe prodhimin e frutave duhet të përgatisë edhe rezervat për vitin e ardhshëm. Për këtë arsye është e rëndësishme që të aplikohet plehrimi me plehra azotike duke përdorur pothuajse 30% të nevojave vjetore.

DIMËR (QETËSI RELATIVE)

FOSFORI POTASI:

Në tokat ranore dhe të lehta të cilat shpesh rezultojnë të varfra në këto elemente mund të aplikohet një plehrim dimëror i cili ka si qëllim të rrisë përmbajtjen e tyre në tokë mbasi siç dihet fosfori dhe potasi janë pak të tretshëm dhe qëndrojnë më gjatë.

NDIKIMI I ELEMENTËVE MINERALË

MBI RITJEN DHE PRODHIMIN E

PEMËVE FRUTURE

AZOTI

Eshtë elementi përcaktues i formimit të indeve bimore dhe i rritjes së tyre; faktor i rëndësishëm i rritjes në gjatësi të degëve e lastarëve të pemëve si dhe elementi ndihmues i fenomenit të absorbimit të elementëve mineralë nga ana e bimës.

Azoti organik përpara se të përdoret nga bima duhet të mineralizohet nga mikroflora e terrenit fillimisht në formë amonjakale e më vonë në formë nitrati .

Ngadalësim i rritjes dhe zverdhje e gjetheve për shkak të mungesës së sintezës së klorofilës e cila shkakton ulje të ndjeshme të prodhimit .

FOSFORI

Eshtë komponenti bazë i acideve nukleike. Ndodhet në tokë në sasi të 0,02% - 0,15% në formë organike. Thithet nga bimët në formën e anioneve (H₂PO₄-).

Mungesa e tij kufizon formimin e ARN-së dhe zvogëlon sintezën e proteinave. Bimët pakësojnë rritjen vegjetative dhe reduktojnë zhvillimin e aparatit rrënjor e në mënyrë të veçantë të qimeve thithëse. Lulëzimi dhe pjekja e frutave vonohen në mënyrë të tepruar duke komprometuar prodhimin.